



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:273008
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05751613

PAKR.nr.261/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Krimeve të Rënda – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vaton Durguti kryetar i kolegjit, Bashkim Hyseni dhe Kadrije Goga –Lubishtani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, në çështjen penale kundër të akuzuarit SH.A, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, të ri kualifikuar në veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK- së, duke vendosur lidhur më ankesën e mbrojtësit të akuzuarit SH.A, av.Gëzim Berisha, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.280/2019, datë 18.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-se, me datë 28.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtëses të akuzuarit Shqipdon Abazi, av.Gëzim Berisha, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.280/2019, datë 18.03.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.280/2019, datë 18.03.2024, të akuzuarin SH.A, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-

së, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej pesëqind (500) €, dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, të cilat dënime do të ekzekutohen pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Është detyruar i akuzuari SH.A, që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor duhet të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) €, si dhe pesëdhjetë (50) € për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimin, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

Nga i akuzuari SH.A, është konfiskuar sasia e narkotikut të llojit marihuanë, në peshë të përgjithshme prej gram, e përdorur për kryerjen e veprës penale.

Të akuzuarit SH.A, i kthehen telefoni Samsung me sim kartelë, i sekuestruar nga policia, pasi nuk është vërtetuar se është përdorur apo përfituar me veprë penale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit SH.A, av.Gëzim Berisha, për shkak të shkeljeve esenciale të dipozitive të procedurës penale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penale, shpenzimet të procedurës penale, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën si të bazuar, aktgjykim e ankimuar ta prish në tersi në të gjitha pikat dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykime.

Prokuroria e Apelit me parashtresën, PPA/I.nr.241/24, datë 02.05.2024 ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit SH.A, av.Gëzim Berisha, ndërsa aktgjykimin i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, në të cilën ka prezantuar mbrojtësi i të akuzuarit SH.A av.Gëzim Berisha dhe prindi të akuzuarit, ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit dhe i akuzuari SH.A edhe pse i njoftuar në mënyrë të rregullt nuk mori pjesë në seancë. Për të akuzuari prindi i tij ka njoftuar kolegjin për gjendjen shëndetësore të akuzuarit duke prezantuar shkresën se për të njëjtin gjykata ka

caktuar masën për ndalim psikiatrik. Mbrojtësi i të akuzuarit SH.A, av.Gëzim Berisha pasi elaboroi ankesën mbeti në tersi pranë pretendimeve ankimore të bërë me shkrim.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioj aktgjykimin e kundërshtuar konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-se dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore në ankesa gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar .

Pretendimet e mbrojtësit në ankesë

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit SH.A, av.Gëzim Berisha, thekson se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkeljeje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nenpar.1.10, paragrafi 2 . nënparagrafi 2.1, 2.2, 2.4, 2.6, 2.7, lidhur me nenin 369 të KPP-së, ngase aktgjykimi i ankimuar nuk është përpiluar sipas ligjit pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i pa qartë në kundërshtim me arsyetimin, kurse në arsyetim nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare, si dhe nuk janë paraqitur arsytet për çdo pikë të aktgjykimit, kurse ato arsye janë paraqitur, nuk janë të paraqitura, ne mënyrë të qartë dhe të plotë, ndërsa disa prej tyre janë kundërthënëse në mes vete. Dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë për faktin se në të nuk janë paraqitur të gjitha elementet e nevojshme të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën është shpallur fajtorë i akuzuari, ngase nuk është theksuar se i akuzuari SH.A e ka kryer veprën penale me dashje, duke pasuar parasysh se kjo vepër penale kryhet vetëm me këtë formë të fajësisë.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike thekson se provat të cilat i ka administruar gjykata janë kundërthënëse mes vete, dëshmia e dëshmitarit F.S, ku në shqyrtim gjyqësor fillimisht nuk e ka njohur emrin e të akuzuarit por pas ballafaqimit me pyetjen e prokurorit thotë se i kujtohet, emri. Ka shtuar se ne vendin ku dyshohet se është kryer kjo vepër penale ka lëvizje të madhe të njerëzve ashtu që i akuzuari ditën kritike nuk ka qenë i vetëm, ashtu siç e përshkruajnë edhe dëshmitaret ku kanë dëshmuar se kanë dëgjuar disa zëra policia, policia dhe një zhurmë e cila ishte krijuar pas aksionit të policisë për arrestimin e disa të dyshuarve.

Lidhur me këtë thekson se deklaratat e dëshmitareve janë kontradiktore, dëshmitari L.K, siç ka deklaruar ditën kritike ka qenë bashkë me të akuzuarin, e që vërtetohet se i akuzuari nuk ka qenë vetëm, prandaj gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur të vërtetoj faktet vendimtare se

kush apo cili e ka hedhur substancën narkotike, e që rrjedhimisht kishte me konsumuar elementet e veprës penale ashtu si është shpallë fajtor i mbrojturi im.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të procedurave ligjore, përkatësisht të nenin 7 dhe nenit 361 të Kodit të Procedurës Penale pasi që detyrohet që me ndërgjegje të vlerësoje çdo provë një nga një dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore të mbrojtësit nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, gjen se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtësit se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe përpilimin e dispozitivit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar konform dispozitave të nenit 369 par.6 të KPPK-së, ku gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 të KPPK-së, duke dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendimin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga të akuzuarit, për të cilën vepër penale i akuzuari për kundër faktit se nuk e kanë pranuar se narkotiku është i tij, megjithatë substancën narkotike i njëjti e kishte hedhur posa e kishte vërejtur policinë, pra gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur përfundimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Të gjeturat lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton që gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike në

këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari SH.A është kryes i veprës penale të rikualifikuar për të cilat është shpallur fajtor.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari SH.A në mënyrën e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor nga fakti se pa autorizim ka poseduar substanca apo preparate, të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope dhe analoge, ashtu që me datë 29.05.2019, rreth orës , në P, në rrugën , po sa kishte vërejtur policinë i ka hedhur tetë qese najloni në tokë, të mbushura me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë të përgjithshme prej gram, e pastaj të njëjtin e kanë ndaluar të policia.

Deri të kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit provave, siç janë: dëgjimi i dëshmitarit F.S, si dhe është lexuar dëshmia e dëshmitarit L.K, si dhe provat materiale si në vijim; Vërtetimet mbi konfiskimin e gjëseneve, i datës 29.05.2019; Raporti i ekzaminimit të substancave narkotike, i datës 30.07.2019, sipas të cilit substanca si më lart ka rezultuar të jetë e llojit marihuanë; Fotoalbumi me substancat narkotike.

Ndërsa pretendimi e mbrojtësit së deklaratat e dëshmitareve janë kontradiktor, pasi që dëshmitari dëshmitarit F.S, ku në shqyrtim gjyqësor fillimisht nuk e ka njohur emrin e të akuzuarit por pas ballafaqimit me pyetjen e prokurorit thotë se i kujtohet emri, ndërsa në vendin ku dyshohet se është kryer kjo vepër penale ka lëvizje të madhe të njerëzve ashtu që i akuzuari ditën kritike nuk ka qenë i vetëm, po ashtu dëshmitari L.K ka deklaruar ditën kritike ka qenë bashkë me të akuzuarin, e që vërtetohet se i akuzuari nuk ka qenë vetëm, prandaj nuk ka arritur të vërtetohet fakti vendimtare se kush apo cili e ka hedhur substancën narkotike, janë pretendime të pa bazuara, pasi që dëshmitari F.S kishte deklaruar se deri sa ishte para marketit duke pastruar hapësirën përpara, *:tani i akuzuari SH.A i kishte gjuajtur disa qese të vogla me diçka brenda para marketit, pastaj kishte vërejtur policinë duke e ndjekur SH.A nga prapa dhe në momentin kur SH.A e kishte vërejtur policinë i ka gjuajtur qeset*”, po ashtu por edhe në sallë të gjyqimit me rastin e identifikimit të tij, i njëjti pa mëdyshje ka konfirmuar se është i njëjti person, ndërsa dëshmitari L.K kishte deklaruar se deri sa ishte duke qëndruar prapa marketit kishte ardhur policia, e në atë moment kishin filluar të iknin duke bërë titur “Policia”....., pasi që ai ishte afër SH.A *“ka pohuar se e kishte parë SH.A në momentin kur e kishte hedhur narkotikun, por nuk e*

dinte se i kujt ishte narkotiku, duke theksuar se me siguri ishte e tij- SH.A, për të cilin ka thënë se shumë rrallë ka përdorur narkotik por nuk ka shitur narkotikë”.

Për rrjedhje, Gjykata e Apelit e Kosovës duke u bazuar nga shpjegimet e sipërcekura, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar.

Me aktgjykimin e ankimuar, nuk është shkelur as ligji penal të cilën mbrojtësi e cek vetë si bazë ankimore kjo për faktin se veprimet e të akuzuarit i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të ricilsuar, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK- së, për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor, se për këtë vepër penale i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të akuzuarit në këtë drejtim.

Të gjeturat për vendimin mbi dënimin

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, të cilën mbrojtësi e cek vetëm si bazë ankimuar pa ju referuar me asnjë fjalë, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e vlerësoj edhe sipas detyrës dhe gjeti se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat e cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimi. Kështu, për të akuzuarin SH.A gjykata e shkallës së parë si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar moshën e re të akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale, përkatësisht i akuzuari në vitin 2019 ka qenë 20 vjeç, ndërsa si rrethanë rënduese ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh se i akuzuari ka qenë i dënuar edhe më parë me aktgjykimet e formës së prerë; PKR.nr.119/2018, për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 të KPRK-së, dhe është dënuar me gjobë 1000 euro dhe burgim gjashtë muaj; PKR.nr.291/2018, për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 të KPRK-së dhe Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 të KPRK, dhe është dënuar me dënim me kusht prej një viti me burgim, në afat verifikimi prej dy vite; dhe P.nr.2544/2022, për veprën penale dhuna në familje nga neni 248 të KPRK-së, dhe është dënuar me dënim me kusht prej gjashtë muaj burgim, në afat verifikimi prej një viti, dënim me gjobë 100 euro dhe Trajtimi me rehabilitim të detyrueshëm të personave të varur nga droga apo alkooli. Duke i vlerësuar rrethanat e lartcekura të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë, dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë të veprës së kryer penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, rrethanave të kryerjes, pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e sipërcekura, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.261/24
Datë: 28.05. 2024

Bashkëpunëtorja profesionale,

Syzana Goxhuli

Kryetar i kolegjit,

Vaton Durguti

Anëtarët e kolegjit:

Bashkim Hyseni

Kadrije Goga-Lubishtani